



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2023:054514

Datë: 17.10.2023

Numri i dokumentit: 04794911

PPP.nr.1058/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtorin profesionale Fatmire Haziri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores M. P nga Prishtina, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Arif Hasi, avokat nga Glllogoci, kundër debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës SHSKUK – QKUK, me seli në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbarimore pagesë e borxhit, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit, kundër Urdhrit për lejimin e Përmbarimit P.nr.215/2020, të datës 27.07.2020, të lejuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Irfan Kërçaku në Prishtinë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 17.10.2023, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

I. APROVOHET i bazuar prapësimi i përfaqësuesit të autorizuar të debitorit Qeveria e Kosovës – Ministria e Shëndetësisë - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës SHSKUK – QKUK, me seli në Prishtinë.

II. SHFUQIZOHET Urdhri për lejimin e Përmbarimit P.nr.215/20, i datës 27.07.2020, i lëshuar nga Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Irfan I Gërçagu në Prishtinë, si dhe REFUZHET i pabazuar propozimi për përmbarim i parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit Arif Hasi, avokat nga Glllogoci.

**A r s y e t i m**

Zyra Përmbarimore e Përmbaruesit Privat Irfan I Gërçagu në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të parashtruar nga e autorizuari i kreditores M. P nga Prishtina, ka lejuar përmbarimin në bazë të Urdhërit Përmbarimor P.nr.215/20, i datës 27.07.2020, në bazë të dokumentit përmbarimor – vendimit të Inspektoratit të Punës 01 Nr.33-216/2020-A të datës

01.05.2020, me të cilin Urdhër është detyruar debitori që të bëjë kompensimin e 1 (një) paga mujore në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 858.49€.

Kundër këtij Urdhëri Përmbarrimor, brenda afatit të paraparë ligjor prapësim ka paraqitur përfaqësuesi i autorizuari i debitorës. Në prapësim, ndër tjera theksohet se në Urdhrin për Përmbarrim është konstatuar në mënyrë të gabuar gjendja faktike, ndërsa në vendimin mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi nuk është caktuar shuma e mjeteve monetare të cilat debitori duhet t'ia paguajë kreditorit. Më tutje pretendohet se dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi nuk mund të paraqitet si dokument ekzekutiv dhe se i njëjti nuk është i përshtatshëm për përmbarrim ashtu siç kërkohet me nenin 27 par.1 dhe nenit 37 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore dhe në këtë kuptim Urdhëri Përmbarrimor është lëshuar në kundërshtim me nenin 71 dhe 73.3 të LPP-së. Si dhe i njëjti është kundërshtim me nenin 24 paragrafi 5 neni 36, 37, 38 pasi të njëjtit vendim nuk iu është bashkangjitur dokumenti përmbarrues origjinal apo kopja e vërtetuar. Po ashtu, pretendohet se propozimi për përmbarrim është paraqitur në kundërshtim me nenin 144 të Ligjit për Procedurën Administrative, i cili parasheh që akti administrativ ekzekutohet kur hynë në fuqi dhe bëhet i ekzekutueshëm nga vetë organi administrativ i cili e ka nxjerrë këtë vendim, ndërsa vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarrimi nuk është bërë ende i ekzekutueshëm sepse sipas këshillës juridike pala e pakënaqur ka pas të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, të drejtë të cilën debitori e ka shfrytëzuar pranë organit të shkallës së dytë të Inspektoratit të Punës dhe ende nuk ka pranuar përgjigje lidhur me këtë ankesë. Gjithashtu nuk mund të ekzekutohet akti administrativ kundër të cilit është bërë ankesa dhe ndaj të cilit nuk është paraparë klauzola. Tutje ka theksuar se përmbarruesi privat ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike pasi bazuar në listën e pagave, kreditorja pagën bazë e ka në shumën prej 659.00 euro, kurse urdhri është lejuar për shumën prej 858.49 euro, në të cilën është futur edhe shtesat në pagë si shujta dhe kujdestaria e që është në kundërshtim me kontratën kolektive sektoriale, e cila ua njeh vetëm pagën bazë, e jo edhe shtesat në to. Bazuar në këto pretendime, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhëri për Përmbarrim.

Përmes përgjigjes në prapësim, i autorizuari i kreditorit i ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuara pretendimet e debitorit të dhëna në prapësim nuk përmbajnë asnjë nga kushtet sipas nenit 71 të LPP-së. Pretendimi se kinse i mungon detyrimi financiar nuk qëndron pasi që në titullin përmbarrues qartë shihet se shuma caktohet në bazë të vërtetimit mbi pranimin e pagës mujore dhe të paguar nga ana e debitorit. Pretendimet e debitorit se përmbarruesi nuk e ka vërtetuar gjendje faktike, nuk qëndron ngase i njëjti nuk ka një detyrë të tillë, por të lejoj përmbarrimin sipas dokumentit përmbarrues, vendimit të inspektoratit të punës dhe në bazë të së cilit ka lejuar përmbarrimin i cili paraqet bazë juridike për caktimin e përmbarrimit duke i plotësuar kushtet ligjore nga neni 21 lidhur me nenin 24 par.5 të LPP-së, në të cilin parashihet se “Përmbarrimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të Vendimit të dhënë në procedurë administrative që nuk është bërë përfundimtare, vetëm po që se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridik, nuk e ndalojnë përmbarrimin”. Gjithashtu ka parashtruar se dokumenti përmbarrimor në rastin konkret i plotëson të gjitha konditat sepse me ligj të veçantë përkatësisht me nenin 6.4 të Ligjit për Inspektoratin e Punës, është paraparë se ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të nxjerrë nga Inspektorati i punës, dhe mbi këtë bazë vendimi nuk ka nevojë të ketë klauzolën e plotfuqishmërisë në kuptim të nenit 24 par.5 të LPP-së, por i nënshtrohet ekzekutimit pa u bërë përfundimtar. Tutje ka theksuar se nuk kemi të bëjmë me aplikim të gabuar të së drejtës materiale sepse sipas nenit 397 par.5 të LPP-së, përcaktohet se kompetente për të caktuar dhe vendosur për përmbarrim sipas dispozitave të këtij ligji që nga hyrja në fuqi nga data 01.01.2014 e deri me datën 30.06.2014, janë si gjykata ashtu edhe përmbarruesit privat. Andaj,

meqenëse kemi të bëjmë me detyrime monetare, i cili nuk bie në çështjet familjare apo kthimin në vend të punës dhe kompensimet tjera, do të thotë mungon vendimi gjyqësor, por propozimi ka të bëjë me përmbartimin e një vendimi që është nxjerr në procedurë administrative, andaj, kjo kompetencë bie mbi përmbartuesit privat. Ka theksuar se qëllimi i debitorit është vetëm shtyrja e përmbartimit, andaj, nga këto arsye ka propozuar që prapësimi të refuzohet si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbartimor.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim si dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se prapësimi është i bazuar për arsyet në vijim:

Dispozita nga neni 24 par.3 e LPP-së parasheh që: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*. Në anën tjetër, neni 27 par.1 i LPP-së përcakton elementet që duhet t’i përmbajë një dokument përmbartimor në mënyrë që të jetë i përshtatshëm për përmbartim. Kjo dispozitë parasheh që *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Referuar mënyrës se si është formuluar, rrjedh se dispozita në fjalë kërkon që elementet e renditura më sipër duhet të përmbushen në mënyrë kumulative dhe mungesa e njërit prej tyre në dokumentin përmbartimor, rrjedhimisht ia heqë cilësinë e dokumentit të përshtatshëm për përmbartim.

Në rastin konkret, propozimi për përmbartim është paraqitur duke u mbështetur në Vendimin e Inspektoratit të Punës, 01Nr.33-216/2020-A të datës 01.05.2020. Në bazë të shqyrtimit të këtij vendimi, Gjykata gjen se në dispozitiv të të njëjtit është aprovuar si e bazuar ankesa e kreditorës M.P dhe është obliguar debitori që në afat prej 8 ditësh të bëjë kompensimin e një 1(një) pagave mujore në emër të shpërblimit jubilar. Megjithatë, këtij Vendimi i mungon shuma e përmbushjes së detyrimit nga ana e debitorit si një nga elementet që duhet t’i përmbajë dokumenti përmbartimor për të qenë i përshtatshëm për përmbartim.

Në prezencën e rrethanave të tilla, Gjykata vlerëson se vendimi mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi në këtë çështje juridike nuk i përmbushë kushtet për të qenë i përshtatshëm për përmbartim në kuptim të dispozitës nga neni 27 par.1 lidhur me nenin 24 të LPP-së.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh faktin se në shkresat e lëndës, përveç vendimit mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi janë të bashkangjitura edhe prova tjera si: ankesën, kontratën e punës, vërtetimin mbi përvojën e punës, kërkesën për përfitimin e shpërblimit jubilar, si dhe listën e pagave, mirëpo Gjykata nënvizon faktin se meqë kemi të bëjmë me procedurë rigorozisht formale, me rastin e vendosjes lidhur me ligjshmërinë e lejimit të përmbartimit, duhet kufizuar vetëm në vlerësimin e përshtatshmërisë së dokumentit përmbartimor, që në rastin konkret është vendimi i Inspektoratit të Punës 01Nr.33-216/2020 – A, të datës 01.05.2020.

Bazuar në këto arsye, meqë Urdhëri Përmbartimor është lejuar mbi bazën e një dokumenti i cili nuk është i përshtatshëm për përmbartim, Gjykata konstatoi se prapësimi i ushtruar nga debitori gjen mbështetje në dispozitën e nenit 71 par.1 pika 1.1 të LPP-së, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke e aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke e shfuqizuar Urdhërin për lejimin e Përmbartimit P.nr.215/2020, të datës 27.07.2020, të lëshuar nga Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Irfan I Kërçagu nga Prishtina, si dhe duke e refuzuar si të

pabazuar propozimin për përmbarrim të parashtruar nga përfaqësuesi e autorizuar e kreditorës M.P.

Nga arsyet e lartëcekura, në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.1058/20, datë 17.10.2023

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.